



Buletin Informativ

Dhjetor 2018

SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

NË KËTË NUMËR

Sipërmarrja dhe të mësuarit për sipërmarrjen

Editorial

Zhvillimi i kapacitetit sipërmarrës të qytetarëve dhe organizatave evropiane është një nga politikat kyçe të BE-së, për implementimin e së cilës ka miratuar Planin e Veprimeve "Për sipërmarrjen 2014-2020. Edhe Shqipëria si vend aspirant për t'u integruar në BE ka ndjekur politikat e BE-së për nxitjen e sipërmarrjes, të cilat i ka pasqyruar në startegjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020 si dhe në planin e veprimeve për implementimin e kësaj strategjie. Pjesë integrale e kësaj startegjie është edhe të mësuarit për sipërmarrjen. Dymbëdhjetë vjet më parë, Komisionit Evropian identifikoi

ndjenjën e iniciativës dhe sipërmarrjes si një nga 8 kompetencat kryesore të nevojshme të edukimit. Por në vitin 2016 Komisioni Europian ndërmorri një studim të mëtejshëm ku përcakttoi kornizën EntreComp. Korniza e paraqitur në këtë studim përbëhet nga 3 fusha të kompetencave të ndërlidhura: 'Ide dhe Mundësi', 'Burime' dhe 'Në Veprim'. Në kuadër të programit IPA II 2014, SHGPAZ është shpallur fituese për projektin "**Nxjtja e Sipërmarrjes dhe të mësuarit për sipërmarrjen tek të rinjtë dhe gratë në Shqipëri**". Për këtë qëllim më datë 11 dhjetor 2018 znj. Flutura Xhabija firmosi kontratën me përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së dhe MF. **SUKSESE**



Ndahen çmimet e gruas sipërmarrëse 2018

Më 22 dhjetor 2018, me rastin e festave, në takimin e fundit të vitit të anëtareve të SHGPAZ, u shpallën çmimet për gratë sipërmarrëse më të sukseshme. F2



Rihapen Fondet e IPARD II për sektorin e Agrobiznesit

Fondi është i hapur nga data 30 Nëntor 2018 dhe do të jetë e mundur të aplikohet deri më 30 Janar 2019. F.9



Ndahen çmimet e gruas sipërmarrëse 2018

nga Flutura Xhabija

Më 22 dhjetor 2018, me rastin e festave të fund vitit në Lezhë u mbajt takimi festues me anëtarët e SHGPAZ, sipërmarrëse të sukseshme në menaxhimin e biznesit të tyre dhe nëna e gra të mira në familje.

Në këtë takim u nderuan disa sipërmarrëse, por çmimin e vitit 2018 e mori **znj.Dile Ujka, pronare e Hotel-Restorant "Detar" në Shëngjin.**

Shkoni dhe provojeni vetë!



Aplikimet e reja për IDEA 2019



Vazhdojnë aplikimet e reja për konkursin e planeve të biznesit deri më datë **11 janar 2019**.

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për çdo biznes të ri.

Pjesëmarrësit kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë sipërmarrëse, të konsolidojnë idenë e tyre të biznesit, dhe të përgatisin një plan biznesi të financueshëm nga skema e granteve IDEA dhe jo vetëm.

Të interesuarit mund të aplikojnë në këtë link: <https://form.jotformeu.com/CEFEInternational/aplikimi2019IDEA>

Bankat dhe biznesi

Vazhdon tkurrja e kredisë gjatë tetor-nëntor 2018

Nga Tefta Demeti


Sipas Bankës së Shqipërisë, të dhënat e kredisë për SME-të tregojnë se performanca e saj vazhdon të jetë të dobët edhe gjatë muajve tetor dhe nëntor 2018.

Tkurrja vjetore e këtij portofoli është shtuar nga tremujori i tretë për të kulmuar në 8% në muajin nëntor. Kjo rënie e kredisë në këtë segment ka reflektuar tkurrjen e ndjeshme të kredisë në lekë si dhe të kredisë në valutë nën ndikimin e mbiçmimit të lekut ndaj euros. Pavarësisht kësaj rënie portofoli i kredisë në lekë jep kontributin kryesor në ecurinë e kredisë për SME-te.

Rënia e financimit për SME-të ka reflektuar si reduktimin e kërkesës për financim pranë bankave ashtu edhe kushtet e shtrënguara të bankave në tremujor e tretë, sikurse konfirmohet nga rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë.

Por kushtet e bankave për biznesin janë më të shtrënguara në Shqipëri edhe në krahasim me të gjithë rajonin, sipas publikimit më të fundit të vrojtimit të aktivitetit kreditues nga banka evropiane për investime- EIB. Më tej, bizneset në Shqipëri paguajnë mesatarisht një kosto më të lartë për marrjen e kredisë

por operacionet janë më pak fitimprurës sesa ato në nivel grupi. Në të njëjtën kohë, shumica e bankave mëmë gjejnë që pozicioni i tyre është



krahasuar me vendet e rajonit që kanë një zhvillim ekonomik të ngjashëm. Gjithashtu edhe ecuria e standardeve të kreditimit tregon se për bizneset ato janë lehtësisht më shtrënguese se në vendet e rajonit duke konfirmuar edhe njëherë politikat ende konservatore që bankat monitorojnë apo vlerësojnë bizneset, në veçanti SME. Sipas EIB bankat kanë raportuar si rritje të moderuar të kërkesave për kredi ashtu dhe përmirësim të kushteve të financimit.

Raporti i kredive të këqija vazhdon të përmirësohet, por ai mbetet ende ndër raportet më të larta në rajon. Përfitimi operacional mesatar i bankave të huaja në Shqipëri raportohet të jetë më i ulët se mesatarja e grupit në përgjithësi. Përsa i përket vlerësimit të grupit për pozicionimin në treg dhe potencialit të tregut: bankat mëmë konsiderojnë se tregu shqiptar ka potencial të mesëm,

ose i kënaqshëm ose optimal.

Kërkesa për kredi në Shqipëri është përmirësuar gradualisht, ndërkohë që kushtet e financimit janë kthyer pozitivisht për herë të parë që nga gjashtëmujori i dytë i vitit 2014. Bankat presin që kërkesa për kredi të mbajë prirjen aktuale pozitive. Kushtet e ofertës së kredisë kanë mbetur prapa kërkesës për kredi, edhe pse me një hendek më të ngushtë të kërkesës, krahasuar me rajonin e CESEE. Kushtet e financimit janë lehtësuar për kreditë e individëve në veçanti. Kërkesa për kredi në Shqipëri është nxitur nga individët gjatë gjashtë muajve të fundit, ndërkohë që kërkesa nga korporatat mbeti e pandryshuar. Cilësia e aplikimeve për kredi vazhdoi të përmirësohej përgjatë harkut kohor të gjashtë muajve të fundit.

Trajtimi i punësimit informal në Shqipëri

Nga Tefta Demeti

Më 21 dhjetor 2018, në ambjentet e Hotel Tirana International u mbajt workshopi për Trajtimin e punësimit informal në Shqipëri. Ky workshop u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, RCC, në kuadër të projektit të BE-së për platformën europiane të punës informale.

Në këtë takim u prezantua studimi për situatën e punësimit informal në Shqipëri si dhe një sërë masash që propozoheshin për trajtimin e informalitetit.

Sipas studimit vlerësohet se rreth 39% e punonjësve punojnë në sektorin informal.

Nga përfaqësuesit e

insitucioneve shtetërore si Zv/ministrja e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Inspektoriati i Punës, Drejtoria e Tatimeve u prezantuan masat e ndërmarra për rritjen e punësimit formal dhe për reduktimin e informalitetit si dhe arritjet nga aksioni kundër informalitetit sidomos në sektorin e turizmit bregdetar gjatë sezonit të verës.




Nga diskutimet edhe të pjesëmarrësve u vlerësua studimi i fundit i RCC duke venë në dukje se që nga studimi i OECD në vitet 2003-2004, si dhe plani i veprimit për reduktimin e informalitetit, nuk ka pasur ndonjë studim tjetër kombëtar. Gjithashtu u vu në dukje se në mjaft raste ka pasur arbitraritet nga insitucionet e kontrollit në biznese si dhe rëndesa e madhe tek biznesi i vogël dhe gjambat e larta të vëna nga ata për shkelje me dëme minimale. Pra kontrollohen dhe gjobiten bizneset formale, ndërsa ato biznese që janë informal nuk kontrollohen apo gjobiten.

Ky studim i RCC si dhe masat e rekomanduara për trajtimin e informalitetit duhet të mbahen parasysh nga insitucionet shtetërore dhe të programohen në planet e tyre të veprimit për një efikasitet më të lartë.

Veprimtaritë gjatë vitit 2018 të SHGPAZ në buletine

Me këtë rast redaksia e SHGPAZ ju uron një Vit të Ri të sukseshëm



NOKIA firmos marrëveshjen e licënsimit të patentave me kompaninë kineze OPPO, një yll në rritje në industrinë e smartphoneve

Nga Albana Laknori

Korporata e Nokias e Telecomit Finlandez, njoftoi se ka firmosur marrëveshjen e licënsimit të patentës me kompaninë kineze të telefonave mobile OPPO në 26 Nentor 2018. Edhe pse nga Nokia nuk janë njoftuar kushtet e kësaj marrëveshjeje, kompania OPPO ka deklaruar se sipas kësaj marrëveshjeje do të paguajë Nokian për një periudhë shumë vjeçare.

Një lojtar i hershëm në telefonat mobile dhe tregjet e smartfoneve, ka vënë fokus më shumë se një infrastrukturë marketingu në vitet e fundit vazhdon të dizenojë hardqare të teknologjisë mobile që e japin me licencë paleve të treta si psh OPPO. Nuk është marrëveshja e parë e licënsimit të smartfoneve kinezë, që ka hyrë në një marrëveshje licëncimi, sepse verën e kaluar bëri marrëveshje me kompaninë Xiaomi, e cila i dha akses patentave të shpikjeve teknologjive standart (SEPs), në sektorin e celularëve. Nokia i kushton një rëndësi të madhe zhvillimit të teknologjive të reja dhe në 3-mujorin e fundit të 2018 kompania në kërkime dhe zhvillime shkencore R&D ka harxhuar 1.1 billion euro (1.2 bilion USD), e cila përbën më shumë se gjysmën e fitimeve bruto të saj.

OPPO edhe pse nuk ka të njëjtën vëmendje si rivalet e tij Xiaomi dhe Huawei, ai po bëhet konkurrenti më i madh në smartphonet kineze në vitet e fundit. OPPO ka një pjesë të madhe të tregut, dhe vetëm gjatë 2016 ajo shiti në Kinë të 78.4 milion njesi smartfone, që përbën rreth 16.8% të tregut në të gjithë vendin. Shitjet në vitin 2018 u rritën me 122.2% krahasuar me vitin e kaluar.

OPPO është bërë gjithashtu një lojtar i madh në tregun global të smartphoneve, duke shitur 29.4 milion njesi vetëm gjatë 3-mujorit të katër të 2018, duke u renditur si shitësi i pestë më i madh i smartphoneve dhe duke zënë 8.6% në tregun global të smartphoneve dhe jo shumë larg rivalit Xiaomi.

Ky njoftim i fundit i marrëveshjes së Nokias për patentën e shpikjes së tij me kompaninë kineze OPPO, nuk është e vetmja marrëveshje e firmosur nga OPPO në muajt e fundit, sipas një interviste ekskluzive të Drejtorit të IP, Adler Feng, të publikuar nga IAM. Gjithashtu në fund të Nëntorit, nga IAM, u publikuan të dhëna që lidhen me aplikimin për patentë të OPPO, e cila ka aplikuar për 5000 patenta në vitin 2016.

Në total 16.826 asetet IP (Pronesia Intelektuale) janë aplikuar në Kinë, dhe në çdo lloj

insitucioni tjetër, duke përfshirë edhe aplikimet në WIPO



(Organizata Nderkombetare e Pronesise Intelektuale).

Që të dyja këto veprime të OPPO, si R&D dhe marrëveshjet e licënsimit, duket se e kanë ndihmuar të mbaje një pozicion të fortë në treg, duke futur teknologji të reja. Raportohet se OPPO do të lëshojë smartphonet e rinj këtë Dhjetor, që kanë të bëjnë me new generation dhe me teknologjinë e akumulimit të tensionit të vazhdueshëm, të tensionit multi-hap me tension të vazhdueshëm (VOOC), ku do të sigurohet kohë shumë e shpejtë e karikimit të baterisë, e cila ka marrë emrin SuperVOOC. Smartphoni OPPO R19, duhet të dalë në treg në 2019, dhe pritet të jetë i pari smartphone në botë, që ka chipsetin MediaTek Helio P80, që është dizenuar për të përmirësuar performancën e inteligjencës artificiale.

Qeveria rrit pagën minimale në 26 mijë lekë

Sindikatat OK, biznesi, “nuk jemi konsultuar”

nga Violeta Shqalsi

Qeveria ka vendosur në mbledhjen e saj të fundit rritjen e pagës minimale me 8.3%, nga 24 mijë në 26 mijë lekë. Ky vendim do të ndihmojë atë pjesë të popullsisë që është më e papaguara dhe pritët të nxisë rritjen e konsumit. Por nëse kjo masë e qeverisë ndikon pozitivisht te punëmarrësi, ka një efekt tjetër te punëdhënësi. Kështu kjo rritje e ka kapur të papërgatitur biznesin.

Sipas përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, Qeveria nuk është konsultuar, dhe se ky vendim godet biznesin prodhues dhe eksportuesit. Lidhur me këtë vendim, ata shprehen se “bizneset po detyrohen që të rrisin pagën artificialisht. Automatikisht po krijohet një kosto ekstra për kompanitë. Kompanitë i rrisin pagat për të qenë konkurrues, me qëllim që të marrin punëtorët më të mirë, por rritja duhet të vijë duke i krijuar mjedis të përshtatshëm për të bërë biznes kompanive”. Sipas tyre, përllogaritet se 10-15% e punëtorëve në sektor janë në pagë minimale, dhe vendosja e pagës minimale iu rrit kostot artificialisht. Rritja e tavanit të pagës minimale thellon paaftësinë e biznesit për të qenë konkurrues dhe gjithashtu minimizon aftësitë për të riinvestuar edhe për të hapur vende të reja pune.

Paga minimale, sipas sipërmarrësve, nuk duhet të rritet me udhëra administrative, por duke krijuar mjedisin e përshtatshëm për bizneset për t’u rritur. Tregu i punës është jashtëzakonisht konkurrues, pasi ne luftojmë për të mbajtur punonjësit. Ky vendim prek më së shumti bizneset eksportuese. Përfaqësues të biznesit shprehen se paga duhet të vendoset nga tregu. Vendosja e këtij tavani me urdhër administrativ sjell abuzime me tregun. Tavani ka bërë që ekonomia të marrë minimumin e mundshëm. Në 4-5 vitet e fundit nuk ka pasur rritje page, kjo do të jetë një kosto ekstra.

Vendimi i qeverisë për rritjen e pagës minimale vjen pas kërkesave të herëpashershme të sindikatave. Rritja e pagës minimale vendim i duhur, por jo i drejtë dhe shembulli malazez. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë vlerëson pozitivisht vendimin e qeverisë Rama për rritjen e pagës minimale me 2 mijë lekë të reja. Ndërkohë Konfederata e Sindikatave vlerëson se paga minimale do duhej të rritej të paktën me 6 mijë lekë të reja, pra të shkonte në 30 mijë lekë.

Qeveria pretendon se rritja ekonomike ka shkuar deri në 5 % ,ndaj rritja e pagës minimale duhej të ishte më e lartë. Paga minimale në vitin 2013 ka qenë



22 mijë lekë e sot shkon në 26 mijë lekë, pra rritja në 6 vite është vetëm me 4 mijë lekë.

Prej vitesh Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë ka kërkuar rritjen e pagës minimale, si një domosdoshmëri në një realitet ku çmimet e shportës njohin rritje, çmimet e produkteve të konsumit njohin rritje, karburantet janë rritur dhe familjet shqiptare sot paguajnë më shumë taksa, paguajnë më shumë ujë e drita e janë kredimarrës në banka. Sot paga minimale në Shqipëri është e ngjashme me Kosovën e Maqedoninë ku paga minimale është përkatësisht 170 euro e 200 euro.

Në këto tre vende vihet re një eksod masiv i popullsisë drejt vendeve të Bashkimit Evropian, për një jetë më të mirë. Shkaku kryesor i eksodit është paga e ulët që ofrohet në këto vende, ndërkohë numri i madh i atyre që largohen janë të rinjtë.

Fqinji yne Mali i Zi e ka pagën minimale 400 euro, ndaj ky vend popullsia e të cilit është vetëm 600 mijë banor nuk është prekur nga eksodi masiv. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë i bën apel qeverisë të rishikojë mundësinë për rritjen e pagës minimale.

FAKTE

29.7%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2017 në Shqipëri rezultojnë 29.7% me një ritje prej 2.9 pikë % krahasuar me 2016, por me një rënie me 1.6 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë)



Takim në ambasadën suedeze

Më datë 18 dhjetor 2018 në
ambjentet e ambasadës suedeze
në Tiranë u mbajt një takim me
ekspertët e trainuar në Suedi
midis të cilëve ishin dhe ekspertët
e SHGPAZ si Juna Xhabija.
Takim për shkëmbim
eksperiencash dhe përfitimet e
trainimeve si dhe zbatimi i tyre në
vend.
Falenderojmë ambasadën
suedeze për këto mundësi të
ofruara për forcimin e

kapaciteteve të shoqërisë civile
në Shqipëri.



Festa e verës në Pogradec

Më 21 dhjetor 2018, me rastin e festës së shijes së verës në Pogradec grupi i SHGPAZ u takua me kryetarin e Bashkisë për të fiksuar këtë eveniment të qytetit.



Vizitë në biznes Lezhë

Më 23 dhjetor 2018 u zhvillua një vizitë ne ateljen e Zafrima Lezhë me pronare Tereza Gega.



Gruaja dhe shëndeti HIV / AIDS

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Çfarë është HIV / AIDS?

HIV (Virusi i Imunodeficiencës Njerëzore) është virusi i cili prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut duke e lënë atë të pambrojtur nga infeksionet dhe nga disa lloje kanceri. Shkatërrimi dhe dëmtimi gradual i funksionit të qelizave të imunitetit i bën individët e infektuar të ndjeshëm ndaj një game të gjerë infeksionesh, lloje kanceri dhe sëmundjesh të tjera që njerëzit me sisteme imunitare të shëndetshme mund t'i luftojnë. Faza më e avancuar e infeksionit HIV është AIDS (Sindroma e Imunodeficiences se Fituar), e cila mund të zgjasë nga 2 deri në 15 vjet për t'u zhvilluar, në varësi të individit. AIDS është përcaktuar si zhvillimi i llojeve të ndryshme të kancerit, infeksioneve apo manifestimeve të tjera të rënda klinike. HIV nuk është sinonim i AIDS. Një person i infektuar me virusin HIV, jo domosdoshmërisht është i sëmurë me AIDS.

Shenjat e AIDS-it

Shenjat ndryshojnë në varësi të fazës së infeksionit. Megjithatë njerëzit që jetojnë me HIV prirjen të jenë më infektues në muajt e pare. Javët e para pas infeksionit fillestar, personat HIV pozitiv mund të mos kenë asnjë shenjë ose mund të shfaqin shenja të ngjashme me gripin si ethe, dhimbje koke, skuqje apo dhimbje fyti. Me dobësimin progresiv të sistemit imunitar, infeksioni përparon dhe një person mund të zhvillojë edhe shenja të tjera si: fryrje e nyjeve limfatike, humbje e madhe në peshë, diarre e vazhdueshme, kollë.

Transmetimi i HIV

Transmetimi i HIV mund të ndodhë nëpërmjet shkëmbimit të një shumëllojshmërie lëngjesh të infektuara të trupit të njeriut si gjaku, qumështi i

gjirit, sperma dhe sekrecionet vaginale. Disa nga sjelljet dhe kushtet që vënë individët në rrezik më të madh për t'u infektuar me HIV përfshijnë:

- Marrëdhëniet seksuale vaginale ose anale të pambrojtura.
- Pasja e një infeksioni tjetër



seksualisht të transmetueshëm si sifilizi, herpesi, klamidia, gonorea dhe vaginosa bakterore.

- Shkëmbimi i mjeteve të kontaminuara si gjilpëra, shiringa e pajisje të tjera gjatë injektimit të drogës.
 - Marrja e injeksioneve apo transfuzioneve të gjakut të pasigurta, transplantit të organeve, si dhe procedurat mjekësore me instrumente të mprehta të kontaminuara.
 - Shpimet aksidentale me gjilpërë (përfshirë dëmtimet e stafit shëndetësor).
- Individët nuk mund të infektohen me HIV nëpërmjet kontaktit të zakonshëm të përditshëm si puthjet, përqafimet, takimi i duarve, ose ndarja e objekteve personale, ushqimit apo ujit, etj.

Diagnoza e HIV dhe AIDS

Është e rëndësishme të theksohet se, testet që përdoren për vendosjen e diagnozës zbulojnë antitrupa të prodhuara nga sistemi imunitar i një individi për të luftuar mikroorganizmat e huaj, dhe jo zbulimin e drejtpërdrejtë të vetë HIV. Sot janë në dispozicion teste të ndryshme që zbulojnë praninë ose mungesën e antitropave të HIV. Shumica e individëve i zhvillojnë këto antitrupa brenda 28 ditësh nga infektimi, dhe për këtë arsye antitropat mund të mos kapen menjëherë pas infeksionit. Kjo periudhë e hershme përfaqëson kohën e rrezikut më të madh për transmetimin e infeksionit, megjithatë transmetimi i HIV mund të ndodhë gjatë gjithë fazave të infeksionit. Ritestimi i individëve që diagnostikohen me HIV është praktikë e mirë për të përjashtuar çdo gabim të mundshëm testimi apo raportimi.

Trajtimi i AIDS-it

Sot infeksioni HIV mund të kontrollohet nëpërmjet përdorimit të terapisë antiretrovirale (ARV) të kombinuar, e cila përbëhet nga 3 ose më shumë barna ARV. Këto të fundit nuk kurojnë infeksionin HIV, por kontrollojnë shumimin e virusit brenda trupit dhe i mundësojnë sistemit imunitar të fuqizojë kapacitetin e tij për të luftuar infeksionet. Mjekimi me ARV zgjat jetën e të sëmurëve dhe rrit cilësinë e saj, duke e shndërruar AIDS-in në një sëmundje kronike.

Rihapen Fondet e IPARD II për sektorin e Agrobiznesit

nga **Esmeralda Ballesha**

Grantet, kreditë e buta, subvencionet janë disa nga format e ndihmesës së biznesit të cilat priten përgjatë gjithë vitit, veçanërisht nga sektori i bujqësisë pasi ato i japin jo vetëm një frymëmarrje biznesit por i japin dhe një shtysë zhvillimit të mëtejshëm të sipërmarrjes.

Le të bëjmë një analizë të shkurtër se ku konsistojnë mundësitë për të përfituar nga ky grant. Fondi është hapur nga data 30 Nëntor 2018 dhe do të jetë e mundur të aplikohet deri më 30 Janar 2019. Duhet përmendur fakti i lënies të një kohëzgjatjeje më të gjatë në aplikim, ku një nga prolematikat që kanë patur më së shumti fermerët në skemat e mëparshme ka qenë pikërisht kohëzgjatja e vetëm një muaji e cila e bënte të pamundur të plotësoje dokumentacionin për një aplikim të suksesshëm.

Fundi i vitit erdhi me një lajm të mirë për të gjithë bizneset që operojnë në sektorin e agrobiznesit, ku pas më shumë se katër vitesh u rihapen grantet e fondit IPARD.

Diçka tjetër e rëndësishme që është shtuar, është fondi total i akodruar kësaj skeme prej 50.33 milion Euro, nga të cilat 75% janë donacion i Bashkimit Europian dhe 25% nga buxheti i shtetit shqiptar.

Fermerët dhe bizneset që operojnë në industrinë e agropërpunimit kanë 3 masa

aplikimi ku më poshtë janë shpeguar shkurtimisht specifikat e secilës prej tyre.

Masa 1 (Investimet në asetet fizike të fermave bujqësore): me buxhet total 21.65 milion EURO, me një minimum prej 10 000 EURO dhe maksimum 500 000 EURO. Përqindja e mbështetjes është 60% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit, 65% nëse investimi bëhet nga një fermer i ri (nën 40 vjeç), 70% për investimet në zonat malore. Nënsektorët që mund të aplikojnë në këtë masë janë: Qumësht, Mish, Fruta, Perime dhe Vreshta.

Nënsektorët që mund të aplikojnë në këtë masë janë: Qumështi dhe përpunimi i qumështit, Përpunimi i mishit, Përpunimi i frutave dhe perimeve dhe Vera

Masa 7 (Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit): me buxhet total 8.30 milion EURO, me një minimum 10 000 EURO, maksimumi 400 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 65% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

Ashtu sikurse dhe në vitet e mëparshme për të parë specifikat e grantit dhe të dokumentacioneve të nevojshme

duhet ti referoheni "Udhëzuesit për Aplikantët" i cili mund të shkarkohet tek faqja e webit të AZHBR www.azhbr.gov.al ose mund të tërhihet fizikisht tek pikat e azhbr në rrethe por dhe të agropikat (Durrës, Fier, Vlorë, Lushnje dhe Korçë) tek



Masa 3 (Investimet në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore): me buxhet total 20.37 milion EURO, me një minimum 25 000 EURO dhe maksimum 2 000 000 EURO. Përqindja e mbështetjes me fonde publike është 50% e totalit të shpenzimeve të pranueshme të investimit.

të cilat ka punonjës të specializuar që mund t'ju ndihmojnë gjatë aplikimit.

Ju urojmë suksese në aplikimet tuaja dhe mos humbni rastin për të përfituar nga një mundësi e tillë që do të ndihmonte në modernizimin e biznesit tuaj.

Muaji për ndërgjegjësimin e dhunës ndaj gruas

Në kuadër të muajit për ndërgjegjësimin e shoqërisë për barazinë gjinore dhe kundër dhunës ndaj grave u



organizuan një sërë takimesh e workshope, një ndër të cilat është edhe takimi I organizuar nga Komisioni European më datë 6 dhjetor 2018 me temë "Ligji mbron gruan".

Në një tjetër takim më datë 16 dhjetor 2018 u diskutua për barazinë gjinore për pronësinë e grave.



Në takimin e dates 13 dhjetor 2018 u

diskutua se gratë janë të forta dhe mund t'ja dalin si në aktivitet biznesi, ashtu edhe në familje dhe edukim të fëmijëve.

Takim me degën e SHGPAZ Pogradec



Më datë 10 dhjetor 2018 presidentja e SHGPAZ, znj.Flutura Xhabija morri pjesë në takimin e organizuar nga anëtarët e SHGPAZ dega Pogradec ku u diskutua rreth arritjeve të degës gjatë vitit 2018.

Shënim: Opinionet e paraqitura në buletin janë ato të vetë ekspertëve dhe nuk paraqesin opinionin e BE-së

Buletin Informativ

Dhjetor 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax: 00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Përgatitur nga:
Msc. Flutura XHABIJA &
Msc.Arlinda DEMETI
&Redaksia